

VENDIM
Nr. 778, datë 5.9.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË OBJEKTIT “POLIAMBULANCA”
SHKODËR, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SHKENCËS, PËR AKADEMINË E ARTEVE SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar dhe të nenit 82 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të objektit “Poliambulanca” Shkodër, me këto të dhëna: sipërfaqe totale objekti 1 770 (një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) m², sipërfaqe nën objekt 590 (pesëqind e nëntëdhjetë) m², sipërfaqe funksionale 631 m², sipërfaqe e përgjithshme 1 221 (një mijë e dyqind e njëzet e një) m², nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për Akademinë e Arteve Shkodër, sipas planimetrive dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Akademisë së Arteve Shkodër t’i kalojë trualli dhe ndërtesa që janë pronë shtetërore.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë dhe Akademia e Arteve Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

[illegible]
$$\begin{aligned} &= 590 \text{ m}^2 \\ &= 1770 \text{ m}^2 \\ &= 631 \text{ m}^2 \\ &= 1221 \text{ m}^2 \end{aligned}$$

- a. Siperfaqe nen objekt
b. Siperfaqe totale objekti
c. Siperfaqe funksionale
d. Siperfaqe e pergjithshme

VERIUI: PRONE PRIVATE I-2 KATE
JUG: RUGA "VILSON"
LINOJE : RUGA KOMITETI I KOSOVES
PERENDIM: SHESHI 2-PRILLI,OBJEKT 2 KATE

LEO JENDE:
KUFIRI I PRONES
POLIKLINIKA 3 KATE
NDERTIM I PERKOHSEM